

VENDIM
Nr. 875, datë 14.12.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT TË FARAVE TË BIMËVE VAJORE DHE FIBRORE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 9, 14, pika 3, 15, pika 3, e 16, pika 4, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farave të bimëve vajore dhe librore, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e paketimit e të etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, të marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim me qëllim vendosjen e tyre në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE TË BIMËVE VAJORE DHE FIBRORE

1. Kriteret që duhet të plotësojë fara e bimëve vajore dhe fibrore për tregtim janë:

a) Të ketë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë sipas kërkesave të këtij vendimi;
b) Të jetë e pajisur me certifikatën zyrtare sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Të jetë e paketuar dhe e etiketuar në përputhje me kriteret e pikës 3, të këtij kreu;

ç) Varieteti ose hibridi prej të cilit është prodhuar fara të jetë i regjistruar në Katalogun Kombëtar;

d) Të plotësojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave të bimëve vajore dhe fibrore:

2.1 Sipas prejardhjes, farat e bimëve vajore dhe fibrore ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Fara parabazë;

b) Fara bazë;

c) Farë e certifikuar e riprodhimit të parë;

ç) Farë e certifikuar e riprodhimit të dytë;

d) Farë e certifikuar e riprodhimit të tretë.

2.2 Farat parabazë përfitohen nga shumëzimi i farave në farishten e shumëzimit të farave të zgjedhura nën përgjegjësinë e seleksionerit për mbrojtjen e varietetit dhe plotësojnë kërkesat e shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.3 Farat bazë (përveç hibrideve) përfitohen nga shumëzimi i farës parabazë, nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas metodave të seleksionimit për mbrojtjen e varietetit dhe kanë për qëllim prodhimin e “farës së certifikuar të riprodhimit të parë” apo “farës së certifikuar të riprodhimit të dytë” ose, kur është e pranueshme, “farës së certifikuar të riprodhimit të tretë”, si dhe plotësojnë kërkesat e shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.4 Farat e certifikuara të riprodhimit të parë janë farat e bimëve vajore dhe fibrore që përfitohen nga shumëzimi i farave bazë ose nëse e përcakton seleksioneri nga fara e një riprodhimi më të hershëm se fara bazë, që përmbushin kërkesat e shtojcave I dhe II, të këtij vendimi, dhe që synojnë prodhimin e farës të kategorisë “Farë e certifikuar e riprodhimit të dytë”.

2.5 Farat e certifikuara të riprodhimit të dytë përfitohen nga shumëzimi i farave të riprodhimit të parë ose nëse e përcakton seleksioneri, të prodhuara direkt nga fara bazë ose nga fara të një riprodhimi më të hershëm që përmbushin kërkesat e shtojcave I dhe II, të këtij vendimi dhe që synojnë prodhimin e farës të kategorisë “Farë e certifikuar e riprodhimit të tretë”.

2.6 Farat e certifikuara të riprodhimit të dytë e kërç monoik janë farat që përfitohen direkt nga fara e

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me direktivën 2002/57/CE të Këshillit, datë 13 qershor 2002, “Për tregtimin e farave të bimëve vajore dhe fibrore”; numri CELEX 02002L0057-20090704, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, O, nr.193, datë 20.7.2002, faqe 74.

certifikuar e riprodhimit të parë, që kanë për qëllim prodhimin e kërpit për t'u korrur në fazën e lulëzimit dhe përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.7 Farat e certifikuara të riprodhimit të tretë (liri fibror, liri vajor) janë fara që përfitohen nga shumëzimi i farave bazë ose nëse e përcakton seleksioneri nga farat e riprodhimit më të hershëm se fara bazë, të destinuara për prodhime të tjera përveç farës së bimëve vajore e fibrore dhe që përmbushin kërkesat e shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.8 Përcaktimi i skemave të prodhimit të kategorive të farave të bimëve vajore e fibrore, sipas grupimit të bimëve (bimë vetëplenuese dhe të kryqëzuara), është detyrë e institucioneve shkencore, subjekteve dhe individëve të veçantë nën monitorimin dhe përgjegjësinë e ESHFF-së.

2.9 Me bimë vajore dhe fibrore nënkuptohen bimët që rrjedhin nga gjinitë dhe speciet e mëposhtme:

Arachis hypogaea	Kikiriku
Brassica juncea (L.) e Czernj. e Cosson	Sinapi i hirtë
Brassica napus L. (partim)	Sinapi
Brassica nigra (L.) Koch	Sinapi i zi (mustard e zezë)
Brassica rapa L. var. silvestris (Lam.) Briggs	Kolza
Cannabis sativa	Kërpi
Carthamus tinctorius L.	Karatami
Carum carvi L.	Cumino, qimnon
Glycine max (L.) Merr.	Soja
Gossypium spp.	Pambuku
Helianthus annuus L.	Lule dielli
Linum usitatissimum L.	Lini tekstil, lini vajor
Papaver somniferum L.	Lulëkuqja
Sinapis alba L.	Sinapi i bardhë

2.10 Gjithashtu, fara të bimëve vajore dhe fibrore konsiderohen edhe farat e mëposhtme:

a) Fara bazë e linjave “inbrede”, një linjë mjaft uniforme dhe e qëndrueshme që arrihet si me anë të vetëpllenimit artificial, e shoqëruar me seleksionim përgjatë shumë brezave pasardhës apo veprime të ngjashme dhe që plotëson kërkesat e shtojcave I dhe II, për farat bazë, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Farë bazë e hibridit të thjeshtë, i cili përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet dy linjave “inbrede”, përcaktuar nga seleksioneri, e cila është e destinuar për prodhimin e hibrideve me kryqëzim të trefishtë ose të dyfishtë dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.11 Cilësia e farave të bimëve vajore dhe fibrore përcaktohet nga këto tregues:

a) Pastërtia e përgjithshme e cila është pesha në përqindje e farave të pastra ndaj peshës së përgjithshme të farës;

b) Fuqia mbirëse e cila është aftësia e farës për të mbirë në kushte të caktuara dhe përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vëna për mbirje;

c) Energjia mbirëse e cila është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar sipas ISTA-s (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave) dhe shprehet në përqindje;

ç) Lagështia e farave e cila është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara për t'u paketuar dhe për t'u tregtuar si material mbjellës.

2.12 Normat për treguesit cilësorë të farave të bimëve vajore dhe fibrore janë të përcaktuara në tabelën A të shtojcës II, të këtij vendimi.

3. Paketimi dhe etiketimi i farave të bimëve vajore dhe fibrore:

3.1 Paketimi i “farës bazë” dhe “farës së certifikuar” të çdo kulture dhe lloji shoqërohet me dy lloj etiketash, që janë etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare që përgatitet dhe lëshohet në treg nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara e bimëve vajore dhe fibrore është certifikuar dhe e kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Farat e bimëve vajore dhe fibrore të kategorive “farat bazë” dhe “farat e certifikuara” tregtohen vetëm në lote homogjene të mbyllura me paketim.

3.3 Paketimet e “farave bazë” dhe “farave të certifikuara” të çdo kulture dhe lloji duhet të kryhen në mënyrë të tillë që, nëse hapen, mbyllja ose ripaketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Ripaketimi i farave të bimëve vajore dhe fibrore bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik për verifikimin e cilësisë së farës me kërkesë të furnizuesit. Nëse ripaketohet, ripaketimi dhe data e ripaketimit duhet të shënohet në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Paketat e “farave parabazë”, “farave bazë” dhe të “farave të certifikuara” të çdo lloji duhet:

a) të jenë të pajisura në pjesën e jashtme me një etiketë zyrtare, e cila nuk ka qenë e përdorur më parë, që

plotëson kushtet e përcaktuara në shtojcën IV, të këtij vendimi, dhe në gjuhën shqipe;

b) të përmbajë një dokument zyrtar, në të njëjtën ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë të paktën informacionin e përcaktuar në shtojcat IV (I) (a) (3), (4) dhe (5). Ky dokument duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën zyrtare të përcaktuar në shkronjën “a”.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i “farës bazë” apo “farës së certifikuar” të çdo lloji përmban edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Farat e shumëzuara nga riprodhimet e “farës parabazë” mund të tregtohen si “fara bazë”, “fara të certifikuar”, “fara të certifikuar të riprodhimit të parë” dhe “fara të certifikuar të riprodhimit të dytë” kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë kontrolluar zyrtarisht nga autoriteti certifikues në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e “farës bazë”;

b) të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) paketat duhet të kenë etiketën zyrtare, e cila duhet të jetë në ngjyrë të bardhë, me një vijë diagonale vjollcë, ku të shënohen të paktën të dhënat e mëposhtme:

i) autoriteti certifikues;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i vulosjes; ose

iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;

v) speciet, duke shënuar të paktën emrin botanik të tyre, të cilat mund të jepen në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit me karaktere latine;

vi) varieteti të shënohet të paktën me karaktere latine;

vii) të dhënat për “farën parabazë”;

viii) riprodhimi.

3.8 Paketat e vogla të farave të bimëve vajore dhe fibrore, duhet:

a) të mbajnë në pjesën e jashtme etiketën e furnizuesit, një përshkrim të shtypur në gjuhën shqipe, në përputhje me shtojcën IV, të këtij vendimi. Kur paketat janë transparente, kjo etiketë mund të vendoset brenda ambalazhit, me kusht që të jetë i mundur leximi. Ngjyra e etiketës do të jetë sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “a”, të pikës 3.5, të këtij kreu;

b) të mbajë në pjesën e jashtme ose në etiketën e furnizuesit një numër të caktuar serial zyrtar.

3.9 Çdo trajtim me plehurat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve që i është bërë “farave bazë” dhe “farave të certifikuar” shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V, të këtij vendimi.

3.10 Për të vendosur në treg sasi që kalojnë mbi 2 kg, fara të bimëve vajore dhe fibrore të importuara duhet të jenë të pajisura me informacionin për:

a) specien;

b) varietetin;

c) kategorinë;

ç) vendin e prodhimit dhe autoritetin zyrtar të kontrollit;

d) vendin eksportues;

dh) importuesin;

e) sasinë e farës.

III. CERTIFIKIMI I FARAVE TË BIMËVE VAJORE DHE FIBRORE

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit:

1.1 Procedurat e certifikimit të farave të bimëve vajore dhe fibrore realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private, sipas përcaktimit në kreun IX, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave të bimëve vajore dhe fibrore të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre është, si më poshtë vijon:

a) Për certifikimin e farave të bimëve vajore dhe fibrore pranë autoritetit certifikues duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

i) kërkesa me shkrim për certifikimin të farës së bimëve vajore dhe fibrore;

ii) licenca përkatëse e lëshuar nga QKB-ja;

iii) aktkontroll për caktimin e ngastrës së farës, zbatimi i kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat e bimëve vajore dhe fibrore dhe modelit në përputhje me shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi;

iv) certifikata e origjinës që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

- v) certifikata fitosanitare e lëshuar nga shërbimi fitosanitar;
- vi) aktaprobimi fushor;
- vii) fletëanaliza laboratorike e treguesve cilësorë për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laboratorit i miratuar nga ministri;
- viii) etiketa e prodhuesit;
- ix) deklarata e konformitetit.

b) Për certifikimin autoriteti certifikues ndjek procedurën, si më poshtë vijon:

i) bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës së bimëve vajore dhe fibrore që do të certifikohet, si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e sipërpërmendur plotëson procesverbalin “Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës së bimëve vajore dhe fibrore”.

ii) përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të sipërpërmendur.

iii) gjatë vlerësimit të dosjes duhet të mbahet parasysh që përmbajtja maksimale e lagështirës për “farat bazë” dhe “farat e certifikuar” të të gjitha llojeve të jetë jo më shumë se 12-13% për farat e bimëve vajore (luledielli, sojë, lini dhe kikiriku) dhe 14% për farat e bimëve fibrore.

iv) në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

c) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

ç) Elementet dhe kriteret e etiketës duhet të jenë sipas germës “A” të shtojcës IV të këtij vendimi;

d) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr dhe plotësuar nga prodhuesi sasi të etiketave zyrtare.

1.3 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare të përfundojë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.4 Për rastet kur ESHFF-ja autorizon kryerjen e procedurave të certifikimit dhe subjekti i autorizuar nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.3, atëherë i interesuari dorëzon ankesë pranë ESHFF-së.

1.5 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar me lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesën pranë ministrit.

1.6 Farat e bimëve vajore dhe fibrore të renditura më poshtë mund të hidhen në treg vetëm nëse ata janë të certifikuar zyrtarisht, si: “farë bazë” ose “farë e certifikuar”:

Brassica L. (partim)-	Rrepa suedeze
Brassica rapa L. var. silvestris (Lam.) Briggs-	Kolza
Cannabis sativa L.-	Kërpi
Carthamus tinctorius L.	(Karatam)
Qimnon L. ose (Kumin)	(Bimë e ngjashme me kopren)
Gossypium spp.	(Pambuku)
Helianthus annuus L.	(Lule dielli)
Linum usitatissimum L. (partim) -	liri

1.7 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëngjitet kërkesës për certifikim të farave të bimëve vajore dhe fibrore është sipas shtojcës V, të këtij vendimi.

2. Kriteret e ruajtjes, marrja e mostrave dhe analiza e farës për certifikim:

2.1 Farat e bimëve vajore dhe fibrore duhet të mbahen në mjedise të përshtatshme, në të cilat gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit, sigurohen temperatura dhe lagështira optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknike për farat e bimëve vajore dhe fibrore. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farave të bimëve vajore e fibrore. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratimin higjieno-sanitar, të lëshuar nga strukturat lokale të shëndetit publik, si dhe me certifikatë për DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim), të lëshuar nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

2.2 Farat e bimëve vajore dhe fibrore tregtohen si të tilla vetëm pasi të jenë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Gjatë përpunimit, farat e bimëve vajore dhe fibrore mund të dezinfektohen e të peletohen me pesticide e lëndë kimike, ushqyese, veprime këto të shoqëruara me shënimin në etiketën përkatëse.

2.3 Furnizuesve të farave të bimëve vajore dhe fibrore u lejoheq që në mjediset e tyre të përpunojnë, të paketojnë dhe të etiketojnë fara të bimëve vajore dhe fibrore edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e farave të bimëve vajore dhe fibrore.

2.4 Procesi i analizës laboratorike të farave të bimëve vajore dhe fibrore për certifikim ushtrohet, mbi:

- a) lotin e farës, si një sasi e dhënë fare e bimëve vajore dhe fibrore, e një riprodhimi dhe e një kategorie që ka pastërti varietore të caktuar;
- b) mostrën, si një sasi fare e marrë në një ose në disa pika të lotit të farës;
- c) kampionin fillestar, si një sasi fare e bimëve vajore dhe fibrore që del nga përzierja e mostrave;
- e) kampionin mesatar, si një pjesë e kampionit fillestar;
- d) provën, si një pjesë e kampionit mesatar, sipas përcaktimeve në shtojcën III, të këtij vendimi.

2.5 Mostrat e farave për analizën e farave të bimëve vajore dhe fibrore për qëllim certifikimi duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar nga ESHFF-ja.

2.6 Për ekzaminimin e farës së bimëve vajore dhe fibrore për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre janë dhënë në shtojcën III, të këtij vendimi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KULTURAT

1. Parabima e parcelave të farës nuk duhet të ketë qenë e papajtueshme me prodhimin e farave të specieve dhe varieteteve të këtyre bimëve. Fusha nuk duhet të ketë bimë që kanë mbirë nga farat e parabimës.

Në rastin e hibrideve të *Brassica napus*, bimët duhet të rriten në një tokë ku kanë kaluar pesë vjet që nga viti i fundit i kultivimit me bimë kryqore *Brassicaceae (Cruciferae)*

2. Kulturat duhen të jenë në përputhje me standardet e mëposhtme, në lidhje me distancat nga burimet fqinje të polenit, të cilat mund të shkaktojnë pllenim të huaj dhe të padëshirueshëm:

Kultura	Distanca minimale (në metra)
1	2
Kryqoret, përveç kolzës, kërpi për fije e vaj, ndryshe nga kërpi monoik, karatami, karabaku, sinapi i bardhë:	
- Për prodhimin e farës bazë	400
- Për prodhimin e farës së certifikuar	200
Kolza:	
- Për prodhimin e farës bazë përveç hibrideve	200
- Për prodhimin e farës bazë të hibridëve	500
- Për prodhimin e farës së certifikuar të varieteteve përveç hibridëve	100
- Për prodhimin e farës së certifikuar të hibridëve	300
Kërpi, kërpi monoik:	
- Për prodhimin e farës bazë	5000
- Për prodhimin e farës së certifikuar	1000
Lule dielli:	
- Për prodhimin e farës bazë për hibride	1500
- Për prodhimin e farës bazë të varieteteve të tjera përveç hibrideve	750
- Për prodhimin e farës së certifikuar	500
<i>Gossypium hirsutum</i> and/or <i>Gossypium barbadense</i> :	
- Për prodhimin e farës bazë, <i>Gossypium hirsutum</i> ,	100
- Për prodhimin e farës bazë, <i>Gossypium barbadense</i>	200
- Për prodhimin e farës së certifikuar të varieteteve johibride dhe hibride intraspecific të <i>Gossypium hirsutum</i> prodhuar me citoplazmë me sterilitet mashkull (CMS)	30
- Për prodhimin e farës të certifikuar të hibrideve intraspecific të <i>Gossypium hirsutum</i> prodhuara me CMS	800
- Për prodhimin e farës së certifikuar të varieteteve johibride dhe hibride	150

intraspecific të <i>Gossypium barbadense</i> prodhuar pa CMS	
- Për prodhimin e farës të certifikuar të hibrideve intraspecific të <i>Gossypium barbadense</i> prodhuara me CMS	800
- Për prodhimin e farës bazë të hibrideve intraspecific të <i>Gossypium hirsutum</i> dhe <i>Gossypium barbadense</i>	200
- Për prodhimin e farës të certifikuar të hibrideve intraspecific të <i>Gossypium hirsutum</i> and <i>Gossypium barbadense</i> dhe hibrideve me CMS	150
- Për prodhimin e farës të certifikuar të hibrideve të <i>Gossypium hirsutum</i> and <i>Gossypium barbadense</i> prodhuar CMS	800

Këto distanca mund të mos merren parasysh, në qoftë se ka mbrojtje të mjaftueshme nga çdo lloj pllenimi i huaj dhe i padëshirueshëm.

3. Kultura duhet të ketë identitet të mjaftueshme dhe pastërti varietore ose, në rastin e një kulture të një linjë të inbrede të lulediellit, identitet dhe pastërti të mjaftueshme në lidhje me karakteristikat e tij.

Për prodhimin e farës së varieteteve hibride të lulediellit, dispozitat e lartpërmendura do të zbatohen edhe për karakteristikat e përbërësve, duke përfshirë sterilitetin mashkullor apo kthimin e pjellorisë.

Në veçanti, kulturat e: sinapi i hirtë, sinapi i zi, kërpi, karatami, karabaku, pambuku dhe hibridet e lulediellit do të jenë në përputhje me standardet e mëposhtme ose kushte të tjera:

A. sinapi i hirtë, sinapi i zi, kërpi, karatami, karabaku dhe pambuku dhe hibride tjera:

Numri i bimëve të specieve, të cilat janë dukshëm të dallueshme dhe nuk bëjnë pjesë në këtë varietet nuk duhet të kalojë:

- 1 (një) për 30 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës bazë”; dhe
- 1 (një) për 10 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës së certifikuar”.

B. Hibride të lulediellit:

a) Përqindja e numrit të bimëve të cilat nuk i përkasin komponentit të mos kalojë:

aa) për prodhimin e farës bazë:	
i) Linjat ingrede:	0.2%
ii) Hibridet e thjeshta:	
- Bimë mashkull, 2% e të cilëve kanë lëshuar polen ndërkohë që shumica e bimëve femra kanë lulëzuar	0.2%
- Prindër femra	0.5%
(bb) for the production of certified seed:	
- komponenti mashkull, bimë cilat kanë lëshuar polen, ndërsa 5% ose më shumë nga bimët femra kanë lulëzuar	0.5%
- komponenti femër	1.0%

b) Për prodhimin e farave të varieteteve hibride, duhet të respektohen norma dhe kushte të tjera si vijon:

aa) një sasi e mjaftueshme pjalmi duhet të lëshohet nga bimët e llojit mashkullor kur bimët e llojit femëror janë në lulëzim;

bb) ku bimët e komponentit femëror kanë hapur pistilat, përqindja me numër të bimëve të komponentit femëror që kanë lëshuar ose që janë duke lëshuar polen nuk duhet të kalojë 0.5%

cc) për prodhimin e farës bazë përqindja totale me numrin e bimëve të komponentit femëror, kur është e qartë se nuk korrespondojnë me komponentët që kanë lëshuar ose janë duke lëshuar polen nuk duhet të kalojë 0.5%

çç) Nëse nuk mund të përmbushen kushtet e përcaktuara në shtojcës II, pjesa I, pika 2, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme: Një komponent me sterilitetin mashkullor që përdoret për prodhimin e farës së certifikuar përmban një linjë ose më shumë linja të rikthimit, specifike, në mënyrë që të paktën një e treta e një bime të ardhur (rritur) nga hibridi të rezultojë prodhues poleni normale në të gjitha aspektet.

C. Hibridet e *Brassica napus*, të prodhuara duke përdorur sterilitetin mashkullor:

a) përqindja e numrit të bimëve të cilat janë dukshëm të ndryshme nga linjat ose komponentët inbred nuk duhet të tejkalojnë:

aa) për prodhimin e farës bazë:	
iii) Linjat inbrede:	0.1%
iv) Hibridet e thjeshta:	
- Komponenti mashkull	0.1%

- Prindër femra	0.2%
(bb) për prodhimin e farës së certifikuar:	
- Komponenti mashkull	0.3%
- Prindër femra	1.0%

b) steriliteti mashkullor duhet të jetë të paktën 99% për prodhimin e farës bazë dhe 98% për prodhimin e farës së certifikuar. Niveli i sterilitetit mashkullor do të vlerësohet duke vrojtuar lulet për mungesë të thekëve;

D. Hybrids of *Gossypium hirsutum* and *Gossypium barbadense*:

a) në kulturat prej të cilave do të prodhohet farë bazë e linjave prindërore të *Gossypium hirsutum* dhe *Gossypium barbadense*, pastërtia varietore minimale e të dyja linjave prindërore femërore dhe mashkullore duhet të jetë 99,8%, kur 5% ose më shumë e bimëve farëprodhuese kanë lule polenpranuese/marrëse. Niveli i shterpësisë mashkullore të linjës së prindërve që prodhojnë farë do të vlerësohet duke shqyrtuar lulet për praninë e thekëve steril dhe nuk duhet të jetë më pak se 99,9%.

b) në kulturat prej të cilave do të prodhohet farë e certifikuar prej varieteteve hibride të *Gossypium hirsutum* dhe/ose *Gossypium barbadense*, pastërtia varietore minimale e të dy prindërve që prodhojnë farë dhe linjës prindërore që prodhon pjalmin duhet të jetë 99,5%, kur 5% ose më shumë e bimëve farëprodhuese kanë lule polenpranuese. Niveli i shterpësisë mashkullore të linjës prindërore që lëshon farë do të vlerësohet duke shqyrtuar lulet për praninë e thekëve steril dhe nuk duhet të jetë më pak se 99,7%.

4. Prania e organizmave të dëmshëm të cilët ulin vlerën e përdorimit të farës duhet të jenë në nivelin më të ulët të mundshëm. Në rastin e sojës ky kusht është i zbatueshëm në veçanti për organizmat *Pseudomonas syringae* pv. *glycinea* *Diaporthe phaseolorum* var. *caulivora* dhe var. *soja*, *Phialophora gregata* dhe *Phytophthora megasperma* f.sp. *glycinea*.

5. plotësimi i standardeve të lartpërmendura apo kushteve të tjera, në rastin e farës bazë, duhet të shqyrtohen në inspektimet zyrtare në terren dhe, në rastin e farës së certifikuar, të shqyrtohet ose në inspektimet zyrtare në terren ose në inspektimet e kryera nën mbikëqyrjen zyrtare. Këto inspektime në terren do të kryhen në përputhje me kushtet e mëposhtme:

A. Gjendja dhe faza e zhvillimit të bimës duhet të lejojnë një ekzaminim të përshtatshëm/ adekuat.

B. Në raste të tjera përveç kulturave hibride të *annuus Helianthus*, *Brassica napus*, *Gossypium hirsutum* dhe *Gossypium barbadense*, duhet të kryhet të paktën një inspektim.

Në rastin e hibrideve të *Helianthus annuus* duhet të kryhen së paku dy inspektime.

Në rastin e hibrideve të *Brassica napus* duhet të kryhen të paktën tri inspektime: i pari duhet të bëhet përpara fazës së lulëzimit, i dyti në fazën e hershme të lulëzimit dhe i treti në fund të fazës së lulëzimit.

Në rastin e hibrideve të *hirsutum Gossypium* dhe/ose të *Gossypium barbadense* duhet të kryhen të paktën tri inspektime: i pari do të bëhet në fazën e hershme të lulëzimit, i dyti para përfundimit të fazës së lulëzimit dhe i treti në fund fazës të lulëzimit, pas heqjes, kur është e përshtatshme, të bimëve mëmëpjalmuese.

C. Madhësia, numri dhe shpërndarja e pjesëve të fushës që do të inspektohen për të shqyrtuar plotësimin e dispozitave të këtij aneksi duhet të përcaktohen në përputhje me metodat përkatëse.

SHTOJCA II KUSHTET QË DUHET PLOTËSOJNË FARËRAT

I. Farat bazë dhe të certifikuara

1. Fara duhet të ketë identitet dhe pastërti varietore të mjaftueshme. Fara e specieve të listuara më poshtë duhet të përputhet në mënyrë të veçantë me standardet e mëposhtme ose kushte të tjera:

Tabela

Speciet dhe kategoritë	Pastërtia minimale. %
Kikiriku:	
- Farë bazë	99,7
- Farë e certifikuar	99,5
Sinapi, varietetet e tjera përveç atyre për qëllime foragjere, Kolza, përveç varieteteve për qëllime foragjere	99,9
- Farë bazë	99,7
- Farë e certifikuar	

- Farat bazë	85	98	0.3	-	0	0 (c) (d)	10	2		
- Farat e certifikuara	85	98	0.3	-	0	0 (c) (d)	10	2		
Kërpi	75	98	-	30(b)	0	0 (c)				(e)
Karatami	75	98	-	5	0	0 (c)				(e)
Karaboti	70	97	-	25(b)	0	0 (c) (d)	10		3	
Soja	80	98	-	5	0	0(c)				
Pambuku	80	98	-	10	0	0(c)				
Luledielli	85	98	-	5	0	0(c)				
Lini										
- Fije	92	99	-	15	0	0(c) (d)			4	2
- Farë	85	99	-	15	0	0(c) (d)			4	2
Lulëkuqja	80	98	-	25(b)	0	0(c) (d)				
Sinapi i bardhë										
- Farat bazë	85	98	0.3	-	0	0(c) (d)	10	2		
- Farat e certifikuara	85	98	0.3	-	0	0(c) (d)	10	5		

B. Standarde ose kushte të tjera të zbatueshme, kur referimi është bërë për farat në tabelën në pjesës 1, pika 3, shkronja A, të këtij aneksi.

a) Përmbajtja maksimale e farave të përcaktuara në kolonën 5 përfshin edhe farat e specieve në kolona 6 deri 11-të.

b) Përcaktimi i përmbajtjes totale të farave të specieve të tjera të bimëve nuk mund të kryhet veçse në rastet kur dyshohet se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në kolonën 5.

c) Përcaktimi i përmbajtjes me numër i farave të *Cuscuta* spp. nuk mund të kryhet përveç nëse ka dyshim në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në kolonën 7.

ç) Prania e një fare të spp. kuskutës në një mostër me një peshë të përcaktuar nuk duhet të konsiderohet si një papastërti kur një mostër e dytë me peshë të njëjtë është pa asnjë farë të spp. Kuskutës.

d) Fara duhet të jetë e pastër nga *Orobanche*; megjithatë, një farë e *Orobanche* në një kampion prej 100 gram nuk do të konsiderohet si papastërti kur një mostër e dytë me 200 gram është e pastër nga *Orobanche*.

5. Prania e organizmave të dëmshëm të cilët ulin dobishmërinë e farës duhet të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm. Në veçanti, farat duhet të jenë në përputhje me standardet ose kushte të tjera të mëposhtme.

Tabela A

Speciet	Organizmat e dëmshëm			
	Përqindja maksimale e numrit të farave të kontaminuara nga organet i dëmshëm (Total për kolona)			Sclerotinia sclerotiorum (numero massimo di sclerozi o fragmenti di sclerozio in un campione del peso stabilito all'allegato III, colonna 4) Myku i bardhë (nr. Maksimal i skleroteve ose copëza slerotike në një kampion peshe e përcaktuar në shtojcën III, kolona 4)
Kalbëzimet	Altenaria spp., Ascochyta linicola (syn. Phoma linicola), Colletotrichum lini, Fusarium spp. Alternaria, Kalbëzimi I zi, Kalbëzimi I thatë	Platyedra gossypiella Krimbi I pambukut		
1	2	3	4	5
Sinapi				10(b)
Kolza				5 (b)
Kërpi	5			
Pambuku			1	
Luledielli	5			10(b)
Lini	5	5(a)		
Sinapi i bardhë				5(b)

B. Standarde ose kushte të tjera të zbatueshme, kur referimi është bërë për farat në tabelën sipas seksionit I, paragrafi 5, shkronja A, të këtij aneksi.

a) Në lirin për file, përqindja maksimale e numrit të farave të kontaminuara ndaj *Ascochyta linicola* (SYN. *Phoma linicola*) nuk duhet të kalojë 1.

b) Përcaktimi i skleroteve ose copëzave sklerotike të (*Sclerotinia sclerotiorum*) nuk mund të kryhet nëse nuk konstatohen dyshime në lidhje me plotësimin e kushteve të parashikuara në kolonën 5 të tabelës.

C. Standardet e veçanta ose kushte të tjera të zbatueshme lidhur me sojën:

Për *Pseudomonas syringae* pv. *glycinea*, (bakteriaozën), numri maksimal i nënmostrave në një mostër prej të paktën 5 000 fara për një lot, e ndarë më tej në pesë nënmostra, nëse rezultojnë të jenë të kontaminuara nga organizmi në fjalë, numri nuk duhet të kalojë 4;

Kur janë identifikuar koloni të dyshuara në të pesë nënmostrat, për të konfirmuar pajtueshmërinë me standardet apo kushtet e mësipërme mund të kryhen testet e duhura biokimike në kolonitë e dyshuara të izoluara në një mjedis preferencial të marrë nga çdo nënmostër.

a) Në lidhje me *Diaporthe phaseolorum*, numri maksimal i farave të kontaminuara nuk duhet të kalojë 15%;

b) Përqindja ndaj peshës të lëndës inerte, çka është përcaktuar në përputhje me metodat me të fundit ndërkombëtare në lidhje me testin, nuk duhet të kalojë 0.3%.

Në përputhje me procedurën sipas nenit 25, paragrafi 2, shtetet anëtare mund të autorizohen që të mos kryejnë ekzaminimin nëse, në bazë të përvojës së fituar, nuk ka dyshim se rregullat dhe kushtet e mësipërme janë plotësuar.

II. FARAT KOMERCIALE

Kushtet e vendosura në seksionin I të aneksit II, me përjashtim të pikës 1, do të zbatohen për farën komerciale.

SHTOJCA III PESHA E LOTTIT DHE MOSTRËS

Speciet	Pesha maksimale e një loti (ton)	Pesha minimale e mostrës që merret një loti (g)	Pesha e mostrës për përcaktimet për numrin e farave të referuara në aneksin II, seksioni I, pika 3, shkronja A, kolona 5 deri 11 dhe shtojca II, seksioni I, pika 4, shkronja A, kolona 5 (g)
Kikiriku	30	1000	1000
Kolza, rapi	10	200	70
Sinapi i hirtë	10	100	40
Sinapi	10	200	100
Sinapi i zi	10	100	40
Kërpi	10	600	600
Karatami	25	900	900
Karaboti	10	200	80
Soja	30	1000	1000
Pambuku	25	1000	1000
Luledielli	25	1000	1000
Lini	10	300	150
Lulëkuqe	10	50	10
Sinapi bardhë	10	400	200

Pesha maksimale e lotit nuk duhet të kalojë më shumë se 5% pesha maksimale e përshkruar

SHTOJCA IV ETIKETA

I. ETIKETA ZYRTARE

A. Informacioni i kërkuar.

1. Autoriteti i certifikimit ose inicialet e tyre.
2. Numri i serisë së etiketës.
3. Numri i referencës së lotit, si dhe data e lëshimit të etiketës.
4. Specia tregohet të paktën me emrin botanik, i cili mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, me germa latine.
5. Nën/specia.
6. Varieteti të tregohet me germa latine.
7. Kategoria.
8. Vendi i prodhimit.
9. Pesha e deklaruar neto ose bruto.
10. Kur janë përdorur pesticide të granuluara ose substanca të veshjes së farave ose shtues të tjerë të ngurtë, duhet të deklarohet natyra e tyre dhe raporti i përafërt midis peshës së farave së pastër dhe peshës totale.

11. Kur fuqia mbirëse është rianalizuar, jepet fjala “rianalizim” që shoqërohet edhe me treguesit “(muaji dhe viti)” dhe shërbimi përgjegjës për rianalizime.

12. Përmasat minimale të etiketës: 110mm x 67 mm

B. Ngjyra e etiketës dhe dokumenti brenda ambalazhit.

Etiketa duhet të jetë me një vijë të bardhë diagonale për “farat parabazë”, me ngjyrë të bardhë për “farat bazë”, me ngjyrë blu për “farat e certifikuar” dhe “fara të certifikuar të riprodhimit të parë”, me ngjyrë të kuqe “fara të certifikuar të riprodhimit të dytë”.

Dokumentit brenda paketës duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën. Dokumenti nuk është i domosdoshëm nëse kërkesat janë të printuara me bojë të pashlyeshme mbi ambalazh ose në qoftë se përdoret një etiketë ngjitëse apo një etiketë e përbërë nga material rezistent.

SHTOJCA V

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË BASHKËNGJITET KËRKESËS PËR CERTIFIKIM

Kërkesë për aplikim

Drejtuar: Entit Shtetëror të Farave dhe Finave

Tiranë

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, parashikuar në neni 12 të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri:

.....

2. Adresa:

.....

3. Emërtimi i subjektit dhe adresa:

.....

4. Nr. NUIS: (nga QKR)

.....

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri:

.....

2. Adresa:

.....

3. Nr. personal i identifikimit:

Te dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet;

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	*
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Afati kohor i tregtimit:.....

Furnizuesi:

Emri mbiemri firma dhe vula vendi dhe data:

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
Sektori i certifikimit zyrtar

PROCESVERBAL MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS

Mbahet sot, më datë, në fermën/ekonominë, fshati, bashkia....., qarku....., për caktimin e ngastrës së farës së kulturës, kultivari....., (hibridi)....., që do të mbillet me farë të riprodhimit, gjatë vitit.....

Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e, me sip.ha, në kushte (mbi ose nën ujë), dhe me distancë izolimi në hapësirë nga kultivarët e tjerë prej ml.

Për realizimin e prodhimit të farës prej kv, furnizuesi merr përsipër të zbatojë këto hallka të teknologjisë:

1.
2.
3.
4.
5.
6.

Procesverbali mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti i farave të DB-së dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

FURNIZUESI

SPEC. DB

SPEC. CERTIFIKIMIT ZYRTAR

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
Sektori i certifikimit zyrtar

CERTIFIKATË E ORIGINËS

“PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND”
(Bazuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, neni 16/c)

Në mbështetje të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”,

neni 16/c”, nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë certifikatë origjine për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e mëposhtme:

Specia
Varieteti
Riprodhimi
Numri referencës
Numri i serisë së etiketës zyrtare
Viti i prodhimit
Vendorigjina

FURNIZUESI

.....
(Firma, vula)

Tiranë, më.....

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

Sektori i certifikimit zyrtar

*AKT KONTROLLI
PËR PARCELËN E FARËS*

(Bazuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, neni 16/a, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”).

I mbajtur sot, më datë, në parcelat e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të furnizuesit z..... qarku, Bashkia, parcela (vendndodhja)..... mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës specia kultivari....., riprodhimi....., të mbjella në një sipërfaqe prej ha. Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kërkesa teknike të përcaktuara;

.....
.....
.....
.....

Ky aktkontroll mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti i farërave të DB-së dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit zyrtar pranë ESHFF-së.

FURNIZUESI

SPEC. FAR. DB-së

SPEC. CERTIFIKIMIT ZYRTAR

AKT APROBIMI

PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS

(Bazuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4. 2011, neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë, nga specialistët e sektorit të certifikimit zyrtar, z....., u bë aprobimi fushor i ngastrës së farës (nr. ose emri.....) në

fermën/ekonominë e furnizuesit z....., fshati, Bashkia

1. Nga të dhënat cilësore të farës rezulton:

Ngastra është mbjellë me farë specia,, kultivari....., riprodhimi; sipërfaqjaha, dokumenti i originës.....

2. Mbas verifikimit del se:

- Është siguruar izolimiml.

- Është zbatuar teknologjia, sipërfaqja e vlefshme për farëha, kultivari (hibridi), riprodhimi, sasia e farës që parashikohet të merretkv, kategoria

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aprobimit paraqitet :

.....
...
.....
...

4. Treguesit e aprobimit fushor:

Pastërtia varietore..... % (.....)

Pastërtia nga barërat e këqija% (.....)

Prekjet nga sëmundjet virusale.....% (.....)

Prekjet nga sëmundjet kërpudhore% (.....)

a) (.....)

b) (.....)

c) Dëmtime nga dëmtuesit (.....)

5. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:

.....
...
.....
...
.....
...

FURNIZUESI

.....
)

GRUPI I APROBIMIT

() () ()

DEKLARATË KONFORMITETI

Unë i nënshkruari....., me licencë nr..... datë....., me NUIS....., me adresë , sot në datën, deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor....., i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi

teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr., datë
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr., datë
3. Është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr., datë
4. Specia
5. Varieteti
6. Riprodhimi
7. Cilësia
8. Është i ambalazhuar në, me peshë
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga
dhe i përket lotit nr.

Lëshoj këtë deklaratë konfirmiteti komform ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, nenet 11 dhe 12, si dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(.....),

Në datën

ETIKETA E PRODHUESIT

Emri i subjektit furnizues

Numri NUIS

Numri i licencës

Vendi i prodhimit

Specia

Fuqia mbirëse

Data e analizës

Trajtimi (emri i pesticidit)

Data e paketimit

Pesha e njësisë së paketimit

ENTI SHITËTËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

ETIKETA ZYRTARE

Nr. i serisë

Specia

Varieteti

Kategoria

Nr. i lotit

Emri i subjektit prodhues

Vendi i prodhimit

Pesha neto e pakos

Data

Rianalizuar: PO / JO Data e rianalizimit:.....

Trajtuar me pesticide ose substanca të tjera kimike PO / JO

Emri i pesticidit ose i substancës

ENTI SHPETËTOR I FARAVE DHE FIDANËVE
Sektori i certifikimit zyrtar

PROCESVERBAL

Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit dhe kontrollin e cilësisë së farës.

Në zbatim të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", mes specialistëve të certifikimit zyrtar z.....dhe furnizuesit z..... sot në datën, mbahet ky procesverbal për verifikimin e treguesve cilësorë dhe dokumentacionit për farën e prodhuar si vijon:

1. Furnizuesi, ka prodhuar farë të species me këta tregues:

- a) Varieteti
- b) Riprodhimi
- c) Viti i prodhimit
- d) Kontingjenti
- e) Nr. i lotit
- f) Etiketa me nr. serisë

Dokumente që disponon :

- a) Certifikatë origjine Nr....., datë
- b) Certifikatë fitosanitare Nr....., datë.....
- c) Fletëanaliza Nr....., datë.....
- d) Certifikatë OECD Nr....., datë.....
- e) Akt aprobimi Nr....., datë.....
- f) Deklaratë konfirmimiti Nr....., datë.....
- g) Procesverbal i kontrollit Nr., datë.....,

Nga verifikimi i dokumenteve, si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike. Për këtë duhet të pajiset me certifikatë zyrtare pasi subjekti të shlyejë tarifën e certifikimit në shumën lekë.

FURNIZUESI

SPECIALISTËT E CERTIFIKIMIT ZYRTAR

.....

(.....) (.....)

ENTI SHPETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TË FARAVE

Vula e laboratorit

FLETË ANALIZA E LOTIT TË FARËS

E LËSHUAR PËR APLIKANTIN				
Emri i aplikantit				
Specia	Kultivari	Kategoria	Pesha e lotit	etj.

INFORMACION

Laboratori i Testimit	Shtetëror
Mostra e sjellë nga	Zyrtare
Nr. i lotit	Natyra e certifikatës
Vula e lotit	

Nr. i mbajtësve	Data e mostrimit	Data e pranimit	Data e testimit	Numri i testit

REZULTATI I ANALIZËS

Emri shkencor i specisë

<i>Pastërta</i>			Nr. ditëve të testit	<i>Mbirja</i>					Lagështia %
% në peshë				në %					
Farë Pastër	Lëndë inerte	Fara tjera		Filiza normal	Fara të forta	Fara të freskëta	Fara Anormale	Fara të vdekura	

Lloji i lëndës inerte.....
Fara të tjera

Përgjegjës i laboratorit

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADIMINSTRIMIT TË UJËRAVE
ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANAVE
AUTORITETI CERTIFIKUES

CERTIFIKATË ZYRTARE

“ PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND “

/ FARËRA /

NR. _____, DATË, _____.

Në mbështetje të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, nenet 17 dhe 18, sektori i certifikimit zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në nenet 15 dhe 16 të këtij ligji dhe e vlerësoi atë të rregullt, lëshon këtë certifikatë zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, farë....., të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farave të prodhuara nga furnizuesi _____, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është pajisur me etiketën zyrtare dhe ka të dhënat që vijon;

Specia
Varieteti
Kodi furnizuesit
Pesha e lotit
Lloji i paketimit
Pesha e njësisë së paketimit
Numri i serisë të etiketës zyrtare
Numri i analizës së kontrollit
Ngjyra e etiketës zyrtare

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PËRGJEGJËSI

Tiranë më ;.....